



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI
Sesioni pranveror

Komisioni për Punë të Jashtme, Diasporë dhe Investime Strategjike
Mbledhja nr. 23
Prishtinë, më 18.5.2018, në orën 13:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

P r o c e s v e r b a l

Në mbledhje morën pjesë: Vjosa Osmani-Sadriu, Time Kadrijaj, Aida Dërguti, Dukagjin Gorani, Elmi Reçica, Sergjan Mitroviç dhe Zafir Berisha.

Munguan: Danush Ademi, Visar Ymeri, Doruntinë Maloku-Kastrati dhe Evgjëni Thaçi-Drăgusha.

Pjesëmarrësit e tjerë: Xhelal Sveçla, deputet; Fatmire Kollçaku, deputete; Donikë Kastrati, Germin; Bled Maliqi, Rinia Shqiptare në Norvegji; Arben Sejđaj, ECOM Kosovo/BE; Nezir Kraki, Universiteti Paris-Est; Vjollca Hajdari, Globalingo; Drilon Gashi, Deloitte U.S; Sebm Hajrizi, Lobin Inter; Hilmi Gashi, Cresmin/Unik CH; Arjan Kashtanjeva, Konsullata në Shtutgard; Ardita Lokaj, specialiste për marrëdhënie me publikun; Venera Kusari, Columbia University; Bahri Troja, MPJ në Austri; Megi Maas, NRW (Gjermani), Ragip Ramaj, Doruntina Gjermani; Jetmir Bakija, Germin; Adelina Muhagjeri, Germin; Arber Bullakaj, Germin CH; Petrit Kusana, The Albanian UK; Ermir Lleshi, Schooll of Advaned; Behram Xharra, Germin.

Nga zyra e komisionit: Manush Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi: Vjosa Osmani Sadriu, kryetare e komisionit.

Rendi i ditës:

Politikat kryesore të dala nga nevojat e diasporës përgjatë implementimit të nismës: “Dialogu i strukturuar për të drejtat e diasporës”.

Time Kadrijaj, iu dëshiroi mirëseardhje përfaqësuesve të diasporës në këtë takim të përbashkët me komisionin, për të cilin tha se e ka në fushëveprimin e tij edhe diasporën. Më tej, tha se ky takim është pjesë e programit “Diaspora Flet”, i organizuar nga Kuvendi i Kosovës, në bashkëpunim me organizatën joqeveritare “GERMIN” dhe është propozuar që të diskutohet lidhur me politikat kryesore të dala nga nevojat e diasporës, përgjatë implementimit të nismës “Dialogu i strukturuar për të drejtat e diasporës. Ajo theksoi se komisioni shpreh dëshirën që të ndihmojë në organizimin e mërgatës në shtetet e ndryshme ku jetojnë ata, si dhe të ndihmojmë në zhvillimin e marrëdhënieve ndërkulturore në mes të Kosovës dhe shteteve ku mërgimtarët janë prezentë. Znj. Kadrijaj njoftoi përfaqësuesit e diasporës edhe për angazhimet e komisionit në hartimin e legjislacionit dhe për procesin e mbikëqyrjes së zbatimit të tij.

Jetmir Bakija, njoftoi se është anëtar i Bordit Këshillues të Germin-it dhe se ka ndihmuar në këtë iniciativë të diasporës. Lidhur me këtë takim, tha se janë përgatitur materialet lidhur me raportet në mes të Kosovës dhe diasporës dhe janë përcaktuar tri tema që i takojnë veprimtarisë së komisionit, e që janë e drejta e votës, përfaqësimi në Kuvend dhe kartoni i gjelbër.

Hilmi Gashi, duke u ndërlidhur me pagesën për kartonin e gjelbër, tha se nuk është një shumë e madhe, por ne si diasporë duhet të dimë se ku shkojnë ato mjete, e po ashtu kur po ndodhin dëmet neve nuk po na kompensohen. Kërkoj që të ketë transparencë se ku po shkojnë ato mjete dhe ato mjete të investohen aty ku është e nevojshme, në të mirë të shoqërisë. Çështje tjetër e rolit të komisionit, tha se është jo vetëm shfrytëzimi i diasporës për lobim, por edhe për marrëveshjet bilaterale, të cilat bëhen me shtetet e ndryshme. Në këtë drejtim, tha se migracionin qarkor nga pjesët gjermanofolëse është duke e implementuar vetëm Gjermania dhe Franca nga pjesët frankofone. Ai tha se janë disa marrëveshje të partneritetit për migracion, të cilat duhet të merren parasysht dhe të adresohen në ministri.

Selam Hajrizi, kërkoi të informohet se cila është politika lobuese e MPJ-së për pesë vendet e BE-së që ende nuk e kanë njohur pavarësinë e Kosovës dhe çka është duke u punuar në këtë aspekt.

Drilon Gashi, u interesuan se ku do të mund të ishte diaspora jonë e dobishme në politikat e jashtme.

Ragip Ramaj, kryetar i shoqatës “Doruntina”, njoftoi për kërkesën e diasporës për hapjen e një kanali televiziv për mërgatën, ku do të transmetohej material nga e gjithë mërgata jonë.

Bahri Troja, në mes tjerash, theksoi se një koordinim më i mirë, i përbashkët i diasporës me ambasadat e konsullatat e Kosovës jashtë vendit, do kishte një kredibilitet më të mirë për Kosovën.

Arian Kashtanjeva, vuri në pah se Ligji për shërbimin e jashtëm gjendet në fazën e rihartimit në MPJ, propozoi që në këtë ligj të parashihet pozita e atasheut për kulturë, i cili pos tjerash, tha se do të merrej edhe me mësimin plotësues të diasporës.

Vjosa Osmani- Sadriu, thekoi se veprimtaria e diasporës, për herë të parë, është përfshirë në këtë komision, në këtë legjislaturë. Pas angazhimeve të cilat i ka pasur ministri i diasporës, tha se në takimin e radhës, me të presim që të kemi ide konkrete nga ai për shfrytëzimin më të mirë të potencialit të diasporës për zhvillimin e Kosovës. Ajo i njoftoi përfaqësuesit e diasporës që së bashku me kryetarin e Komisionit për Buxhet janë angazhuar për rihapjen e çështjes së kartonit të gjelbër dhe se janë takuar me një sërë institucionesh për zgjidhjen e kësaj çështjeje. Po ashtu, znj. Osmani bëri të ditur se pritet që Komisioni për Buxhet, brenda javës, të dalë me një rekomandim konkret për Kuvend, lidhur me kartonin e gjelbër. Ajo theksoi se komisioni nuk ka kapacitetet e mjaftueshme për të punuar dhe për të bërë analiza e hulumtime të nevojshme dhe shkëmbimi profesional me diasporën do të ishte një çështje bashkëpunimi. Në këtë drejtim, theksoi se organizatori i këtij takimi do të mund të identifikonte një ose dy persona, të cilit do të mund të ndihmonin komisionin tonë. Lidhur me kërkesën për hapjen e një kanali televiziv për diasporën, tha se i pëlqen ideja, porse i duhet komisionit që ta ketë koncept-dokumentin për të parë këtë ide. Sa i përket lobimit në 5 vendet e BE-së, që nuk e kanë njohur Kosovën, njoftoi se kontaktet më të shpeshta janë me Rumaninë, Sllovakinë e Greqinë dhe nga takimet në organizime të ndryshme me këto shtete ka ndikuar në zbutjen e qëndrimeve të tyre në raport me Kosovën. Me Spanjën dhe Qipron, tha se kontaktet janë minimizuar, me Spanjën kontaktet janë më të vogla se që kanë qenë para 10 viteve, e po ashtu edhe me Qipron, në vitet e

fundit, nuk ka ndonjë zhvillim pozitiv. Lidhur me procedimin e Projektligjit për shërbimin e jashtëm, për miratim në Kuvend, theksoi se për komisionin propozimet e diasporës do të jenë të mirëseardhura. **Megi Maas**, në mes tjerash, theksoi se në Bruksel nuk janë në dijeni për të arriturat dhe zhvillimin e Kosovës. Ajo propozoi që të bëhet një kërkesë nga MPJ për Komisionin Evropian, për hapjen e një zyre ndërlidhëse në Bruksel, e cila do të ndihmonte integrimin e Kosovës në BE. Njëkohësisht, kërkoi hapjen e një konsullate të Kosovës në vendin e saj, brenda së cilës do të duhej të ishte një atashë i sportit, kulturës dhe i ekonomisë.

Aida Dërguti, theksoi se remitencat e ruajnë paqen sociale në Kosovë, por do të ishte mirë që të ishin investim në zhvillim ekonomik të qëndrueshëm. Përqendrimi i mjeteve të diasporës, përmes një fondi zhvillimor, do të mundësonte një fond investues, i cili do të hapte vende të punës dhe do të ndihmonte zhvillimin ekonomik të vendit. Me reformën zgjedhore, tha se duhet shikuar mundësinë se si të kemi një përfaqësim të duhur të diasporës edhe brenda Kuvendit të Kosovës, përtej partive politike që janë në Kuvend.

Venera Kusari, përfaqësuese e diasporës në Nju-Jork, theksoi nevojën që për kërkesat e diasporës të formohen mekanizma e grupe punuese që do të merreshin me nevojat e tyre dhe ato të Kosovës. Ajo bëri të ditur se në Nju-Jork nuk ka asnjë institucion që merret me studime albanologjike.

Ardita Lokaj, përfaqësuese e diasporës në Kroaci, pos tjerash, njoftoi se ka punuar një hulumtim për Kosovën dhe rrjedhat e saj gjatë këtyre viteve, për të cilin theksoi se e ka njoftuar ambasadën tonë dhe është e gatshme që ta ndajë edhe me komisionin.

Përfaqësues të diasporës shprehën gatishmërinë që të ndihmojnë në lobim në pesë vendet e BE-së, që nuk e kanë njohur Kosovën. Njëkohësisht, u kërkua që të ketë atashë kulture në Paris, e po ashtu të ketë edhe qendër kulturore pranë secilës ambasadë të Kosovës. Në takim u përsëritën kërkesat e diasporës, me shpresë që të adresohen ato.

Zafir Berisha, theksoi se Kosova është në përpjekjet e saj, për t'u bërë shtet, është një vend i cili ka dalë nga një luftë e përgjakshme dhe e ka shpallur pavarësinë e saj. Ai njoftoi se sa i përket kartonit të gjelbër është preokupim i cili është ngritur disa herë edhe më parë në Kuvend. Po ashtu, njoftoi se me rastin e vizitës së tij me grupin punues në Zvicër, i ka lindur ideja për hapjen e qendrave kulturore rreth konsullatave e ambasadave tona. Theksoi se përkrah propozimin për hapjen e një kanali televiziv për diasporën, që të ketë një kanal të veçantë. Po ashtu, z. Berisha përkrah këtë organizim të diasporës, për të cilin tha se duhet të vazhdohet prapë pas një viti, duke vënë në pah se tani diaspora nuk është ajo që ka qenë dikur, por është e integruar dhe ajo është lobimi më i mirë për shtetin e Kosovës.

Elmi Reçica, theksoi se tani kemi një diasporë të integruar dhe të shkolluar dhe se shpeshherë nuk jemi të vetëdijshëm për të arriturat e saj. Ai tha se mungon një organizim i përbashkët për shfrytëzimin e kapaciteteve tona. Kërkoi që diaspora të ndikojë në hapjen e rrugës për investime strategjike në Kosovë, që ato t'i sjellë apo edhe t'i mbështesë këtu. Sa i përket ndryshimit të Ligjit për shërbimin e jashtëm, theksoi se mund t'i marrin parasysh propozimet e tyre për t'i inkorporuar në ligj. Po ashtu, z. Reçica njoftoi për kërkesën për hapjen e një konsullate të re në Dyseldorf. Lidhur me procesin e anëtarësimit në Interpol, theksoi se është e nevojshme ndihma e diasporës në lobim, qoftë te shtetet të cilat e kanë njohur, por edhe tek ato të cilat kanë hezitur të na njohin. Më tej, tha se si komision dëshirojmë që ta standardizojmë komunikimin dhe kjo organizatë ta ketë prezencën e saj të çfarëdo forme në komision. Ai, njëkohësisht, theksoi se është i nevojshëm bashkëpunimi me gjeneratën e tretë, e cila është e shkolluar si dhe kërkoi nga ata që të ruhet identiteti shqiptar.

Fatmire Kollçaku, sa i përket afrimit të diasporës shqiptare, tha se më shumë ka bërë platforma digjitale dhe rrejtë kabllor sesa ambasadat dhe konsullatat tona. Njoftoi se Kosova është në ndërtim të diplomatëve të karrierës, me qëllim që të dërgohen sa më shumë njerëz profesionalë në përfaqësitë tona jashtë. Sa i përket lobimit, znj. Kollçaku tha se ju nuk mund të flisni në vendet ku jetoni për Kosovën, përtej realitetit të Kosovës dhe ju duhet të përmirësoni imazhin e Kosovës më mirë se që është me të vërtetë. Shprehu mendimin se në Kuvendin e Kosovës duhet të jetë një vend i rezervuar për përfaqësuesit e mërgatës, për t'i mbrojtur interesat e qytetarëve që jetojnë jashtë. Lidhur me investimet e diasporës, tha se në Kosovë nuk ka lehtësira për diasporën, që të investojë, sepse ka pengesa, siç është korrupsioni, dhe se për këtë arsye, njerëzit heqin dorë nga të bërit biznes në Kosovë. Po ashtu, znj. Kollçaku shtoi se në ato vende ku Kosova ka objektet e saj, duhet të votohet fizikisht, pasi që procedurat për të votuar përmes internetit janë shumë të komplikuar. Më tej, tha se ky takim duhet të jetë fillim i një bashkëpunimi të mirëfilltë dhe të shërbejë që të kalohet nga fjalët në vepra.

Xhelal Sveçla, tha se diaspora ka qenë më aktive në vitet e '90-ta sesa që është tash, ngase e kanë ditur se çfarë dëshirojnë, si dhe për shkak të situatës së atëhershme, mobilizimi ka qenë më i madh. Kërkesat e diasporës i cilësoi minimale, duke pasur parasysh kontributin e diasporës. Ai theksoi se është i rëndësishëm kanalizimi i fondeve që i dërgon diaspora, në mënyrë që të gjenerohen të ardhurat. Kërkoj që diaspora të mos heqë dorë nga e drejta e votës, për shkak të procedurave të komplikuar, duke shtuar se do të punohet që edhe e drejta e përfaqësimit të diasporës të ndodhë. Sipas tij, situata në Kosovë është më e keqe, sesa paraqitet në raporte të ndryshme, sa i përket nivelit të arsimit, testi i PISA-s na ka treguar se ku ndodhemi. Pos tjerash, ai theksoi se diasporën nuk duhet ta shohim të ndarë në aspektin e përkatësisë territoriale.

Time Kadrijaj, theksoi se të gjitha opinionet, kërkesat dhe qëndrimet e shprehura nga përfaqësuesit e diasporës, që bien në fushëveprimin e komisionit, do t'i marrin me seriozitet. Me rastin e procedimit të Projektligjit për diasporën dhe për shërbimin e jashtëm, do ta kemi parasysh që të hartohet një ligj i mirë për diasporën, me anë të të cilit përfaqësohen interesat e diasporës. Ajo theksoi se në saje të angazhimit të diasporës dhe fondeve që janë ndarë nga ata, ne kemi mbijetuar dhe e kemi zhvilluar luftën e UÇK-së.

Mbledhja përfundoi në orën 15:40.

Kryetarja e komisionit,

Vjosa Osmani-Sadriu

E përgatiti:

Njësia për mbështetjen e komisionit.